



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.370/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “HIB Petrol” SH.P.K., nga fshati Talinoc i Muhaxherëve, Komuna Ferizaj, kundër debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me adresë në magjistralen Prishtinë – Lipjan, Komuna Gracanicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gracanicë, PPPI.nr.02/2020 të datës 29.07.2021, me datë 14.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit Viva Fresh SH.P.K., me adresë në magjistralen Prishtinë – Lipjan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gracanicë, PPPI.nr.02/2020 i datës 29.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë–Dega në Gracanicë, me aktvendimin e ankimuar PPPI.nr.02/2020 të datës 29.07.2021, ka refuzuar kundërshtimin e debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me numër biznesi 70367151 me adresë në autostradën Prishtinë – Lipjan, të parashtruar kundër urdhrorit të përmbartuesit privat Esat Murati nga Prishtina, P.nr.9/2020 i datës 15.01.2020, si të pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohet si i kundërligjshëm dhe i pabazuar aktvendimi i ankimuar ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e debitorit, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pathemeltë dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigje në ankesë, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori HIB Petrol” SH.P.K., nga fshati Talinoc i Muhaxherëve, Komuna Ferizaj, me datë 15.01.2020 ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me adresë në magjistralen Prishtinë – Lipjan, Komuna Gracanicë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.FDV18-9-008769 të datës 30.11.2018, në shumën e përgjithshme prej 4,139.15 Euro.

Përmbaeruesi privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.9/2020 të datës 15.01.2020, ka lejuar përmbaerimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbaerim.

Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 28.01.2020 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se ka paguar borxhin e faturës në bazë të së cilës është lejuar përmbaerimi, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbaerim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 31.01.2020, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se ka paguar faturën kontestuese, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet urdhri përmbaerimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Gracanicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPPI.nr.02/2020 të datës 29.07.2021, me të cilin ka refuzuar kundërshtimin e debitorit “Viva Fresh” SH.P.K., me numër biznesi 70367151 me adresë në autostradën Prishtinë – Lipjan, të parashtruar kundër urdhrin të përmbaeruesit privat Eset Murati nga Prishtina, P.nr.9/2020 të datës 15.01.2020, si të pa bazuar, me arsyetimin se prapësimi i debitorit nuk është mbështetur në prova.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaerimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaeruesit privat P.nr.9/2020 të datës 15.01.2020, me të cilin është caktuar përmbaerimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbaerimi është lejuar në bazë të faturës origjinale me nr.FDV18-9-008769 të datës 30.11.2018, në shumën e përgjithshme prej 44,724.92 Euro, e lëshuare nga kreditori, e cila faturë në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbaerimit, në shumën e papaguar prej 4,139.15€ ashtu siç

përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të LPP-së. Propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së, ku shprehimisht theksohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumentit tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, çka edhe kjo gjykate vlerëson se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen, nga e cila faturë e besueshme e paraqitur në origjinal është caktuar përmbarimi.

Në rastin konkret Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, të cilën kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase fatura e lartcekur, në bazë të së cilës është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse e njëjta është pranuar dhe vulosur nga debitori, prandaj gjykata vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime ti refuzoj si të pabazuara.

Ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit se i njëjti ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë këto pretendime për arsye se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se debitori ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit të kërkuar në bazë të faturës nr..FDV18-9-008769 të datës 30.11.2018, pasi që në dëshminë e pagesës së prezantuar nga debitori nuk rezulton të jetë paguar shuma e kërkuar me faturën kontestuese nr.FDV18-9-008769 të datës 30.11.2018 në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarim. Andaj në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura dhe shkresave të lëndës rezulton se urdhri përmbarimor është paraqitur konform dispozitave të LPP-së.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.370/2023, me datë 14.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha